



Teknik /e Pajisjesh Fiskale

Rreth BNT Electronics

Themeluar në vitin 1994, ne jemi një nga kompanitë kryesore të teknologjisë në Shqipëri, me gamë të gjerë zgjidhjesh inovative për Sisteme Fiskale, Software, IT, Printera dhe Fotokopje, si dhe Sisteme Mjekësore. **Ofrojmë** shërbime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë kombëtare duke i kthyer teknologjitë e avancuara në vlerë të shtuar për klientët tanë. Me mbi **70** punonjës dhe një rrjet prej rreth **110** partnerësh që shtrihet në të gjithë vendin, ofrojmë ekspertizë të certifikuar dhe suport me në qendër klientin.

Jemi duke kërkuar një teknik/e që t'i bashkohet ekipit tonë të pajisjeve fiskale. Në këtë rol, Ti do të merresh me konfigurimin fillestar të pajisjeve fiskale në ditën e blerjes, do të kryesh kontrole vjetore dhe diagnostikim/riparime të pajisjeve që kanë nevojë për ndërhyrje, si dhe do të udhëzosh klientët hap-pas-hapi nëpërmjet telefonit. Puna kryhet nga zyra (klientët i sjellin pajisjet te ne) dhe me ditë pune *remote* të planifikuara për suport telefonik.

Cilat do të jenë detyrat e tua kryesore?

- Asistencë nga telefoni për klientin, mbi përdorimin e pajisjeve fiskale.
- Asistencë nga telefoni për *troubleshooting* me klientin në linjë.
- Konfigurim fillestar me blerjen e pajisjes fiskale nga klienti.
- Diagnostifikim i dëmit në pajisje (nga sporteli: klientët i sjellin pajisjet te ne).
- Riparim i pajisjes në tryezë me zëvendësim pjesësh.

- Kontrolle/ndërhyrje ndreqëse në *firmware*.
- Dokumentim me shkrim i ndërhyrjeve/asistencës.
- Demonstrimi i pajisjes kur merret në dorëzim nga klienti.
- Koordinim i ngushtë me ekipin teknik.

Cilat janë aftësitë që do të ta bëjnë këtë punë më të lehtë?

- Kërkohet formim profesional në elektronikë (i mesëm ose i lartë) ose kualifikime të ngjashme në fushën e *ICT*.
- Kuptim teknik i bazave të *firmware*, përdorimi i pavarur i *Windows* dhe *CRM*.
- Përvojë në shërbimin ndaj klientit dhe trajnimin e përdoruesve.
- Komunikim i qartë dhe i qetë në telefon dhe me klientin në sportel.
- Aftësi për konfigurim pajisjesh, diagnostikim në raste mosfunksionimi të rregullt të pajisjes.
- Aftësi për të kapur detajet, për t'u dhënë drejtim punëve me përparësi dhe për shfrytëzimin optimal të kohës.
- Disiplinë në punë. Kuriozitet. Aftësi për t'u përshtatur. Frymë bashkëpunuese.

Çfarë ofrojmë?

- Mjedis pune stimulus dhe ekip bashkëpunues.
- Orar fleksibël dhe punë hibride (kombinim i punës në zyrë dhe nga shtëpia).
- Punësim sipas Kodit të Punës me pagë konkurruese dhe 22 ditë pushimi vjetor të paguara.
- Zyra me vendndodhje tërheqëse në qendër të Tiranës.

Mirëpresim aplikim tënd për punë! Dërgoje CV-në tani!
careers@bntelectronics.com